



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-067

Prishtinë, më 8 qershor 2012, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 8 QERSHOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
2. Të ndryshme.

1. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 14 qershor 2012, me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

2. Të ndryshme:

2.1. Njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2011

Kryesia u njoftua me vendimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm - kompaninë audituese **“DELOITTE”** - Prishtinë, për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2011.

2.2. Njoftimi me përmbledhjen e rekomandimeve të raportit të vlerësimit, të analizës dhe të udhëzuesve, përgatitur nga ekspertët e Projektit të Binjakëzimit

Kryesia u njoftua me përmbledhjen e rekomandimeve të raportit të vlerësimit, të analizës dhe të udhëzuesve, të përgatitur nga ekspertët e Projektit të Binjakëzimit lidhur me organizimin dhe funksionimin e Administratës së Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **10:40** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale